



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

**Prishtina, 14 qershor 2021
Nr. Ref.:RK 1808/21**

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI131/20

Parashtrues

Arjana Syla

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev.351/2019 të 25 qershorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arjana Syla nga Prishtina, e përfaqësuar nga Xhemajl Syla nga Podujeva (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev.351/2019] e 25 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 59 [Llojet e vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 shtator 2020, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues) Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 28 shtator 2020, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 6 tetor 2020, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e dorëzoi autorizimin në Gjykatë.
9. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi për herë të dytë kërkesë në Gjykatë në lidhje me rastin e saj, duke kontestuar vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta. Më parë ajo kishte parashtruar kërkesën me nr. KI121/11, përmes të cilës kontestonte Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.134/2010, të 17 majit 2011. Gjykata do ta paraqesë gjendjen faktike në mënyrë të ndarë për secilin rast individualisht, atë: KI121/11 dhe KI131/20.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën KI121/11

11. Prona e kontestuar, banesa përdhesë me sipërfaqe 73.58 m², i është dhënë në shfrytëzim Xh.J., atëbotë punëtor i Organizatës së Bashkuar të Punës “Televizioni Prishtina”, përmes kontratës nr. 01-2218, të datës 10 prill 1979.
12. Më pas, më 8 tetor 1979, Xh. J. kishte lidhur kontratë nr. 1193/9287 me BVI-në për banim dhe hapësirë afariste në Prishtinë, për shfrytëzim të përhershëm të banesës së bashku me bashkëshorten e tij, e cila gjithashtu ishte punëtore e “Televizionit Prishtina”.
13. Ne vitin 1994, pas dëbimit nga puna të Xh.J. dhe bashkëshortes së tij, ata dëbohen edhe nga banesa.
14. Më 15 shkurt 1994, Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Banesore i Kuvendit të Prishtinës, me aktvendimin nr. 360-389 i jep në shfrytëzim të përhershëm banesën e lartcekur N.V.
15. Më 14 maj 1997, N.V., e cila në atë kohë punonte në Gjykatën Komunale në Prishtinë, lidh kontratën nr. 287/1 me Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, për qiramarrje të banesës së lartcekur.
16. Më 26 mars 1999, N.V. lidh kontratën Vr.nr. 107/99 për shitblerjen e banesës se lartcekur, dhe që nga ajo kohë figuron si pronare e banesës.
17. Më 28 prill 2005, bashkëshorti i parashtrueses F.S. (tashmë i ndjerë) ka lidhur kontratë të shitblerjes me N.V., duke paguar 50.000 € (pesëdhjetëmijë euro). Kjo kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me shenjën Vr. nr. 4424/2005
18. Në ndërkohë, në Drejtorinë për Çështje Pronësore-Banesore – HABITAT, janë dorëzuar tri kërkesa për shqyrtim lidhur me banesën e kontestuar: Ajo e Xh.J. me nr. DS008127, e N.V. me nr. DS 00419 dhe e D.P. me nr. DS 603193.
19. Më 30 prill 2005, DÇB përmes vendimit [HPCC/D/181/2005/A&C], personit Xh.J., kërkesa e të cilit ishte kualifikuar si kërkesë e kategorisë “A”, i njihet e drejta e banimit në banesën lëndore dhe e njëjta i rikthehet, ndërsa kërkesat e N.V. dhe D.P. të kualifikuara si kërkesa të kategorisë “C” përfshirë këtu edhe kërkesën e F.S., lidhur me këtë banesë ishin refuzuar.
20. Pas plotfuqishmërisë së vendimit të Komisionit, Xh.J. ka kërkuar kthimin e posedimit të pronës. Zyrtarët e Drejtorisë për Çështje Pronësore-Banesore – HABITAT më 7 maj 2007, e kanë liruar pronën nga njerëzit dhe sendet, ndërsa më 8 maj 2007, çelësat e pronës i janë dorëzuar z. Xh. J. dhe pas kësaj Drejtoria për Çështje Pronësore-Banesore – HABITAT i ka mbyllur të tri kërkesat: DS000419, DS008127 dhe DS603193 me ç’rast përfundon juridiksioni i saj mbi këtë çështje.

21. Në një datë të paspecifikuar, personi F.S. (bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses së kërkesës) paraqiti padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale) kundër personit XH.J., ku kishte kërkuar që të detyrohet i padituri që banesën kontestuese ta lirojë nga të gjithë njerëzit dhe sendet dhe t'ia dorëzojë në posedim paditësit, me pretendimin se ai ishte pronar në bazë të kontratës së shitblerjes (Vr.nr.4424/2005) të 22 qershorit 2005.
22. Më 28 maj 2009, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C.nr.1185/2007] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit F.S., me të cilën ka kërkuar të detyrohet i padituri XH.J. që ta lirojë banesën nga njerëzit dhe sendet dhe t'ia dorëzojë në posedim paditësit.
23. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [C.nr.1185/2007], F.S. paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut), me propozimin që aktgjykimi ankimor të ndryshohet ose priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
24. Më 4 mars 2010, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [Ac.nr.1412/2009] (i) miratoi ankesën e paditësit F.S. si të bazuar; (ii) ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C.nr.1185/2007] të 28 majit 2009; (iii) detyroi të paditurin XH.J. që t'ia lirojë nga njerëzit dhe sendet dhe t'ia dorëzojë në posedim paditësit banesën dydhomëshe- podrum e cila gjendet në Prishtinë në lagjen "Ulpiana" C-2/1 në sipërfaqe prej 52.00 m².
25. Në një datë të paspecifikuar, personi XH.J. kishte parashtruar revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, pranë Gjykatës Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet, ashtu që të hedhet padia si e palejuar.
26. Më 17 maj 2011, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.134/2010] kishte pranuar kërkesën për revizion si të bazuar, ku kishte vendosur që ta ndryshojë Aktgjykimin [Ac.nr.1412/2009] të 4 marsit 2010 të Gjykatës së Qarkut, ndërsa Aktgjykimin [C.nr.1185/2007] e 28 majit 2009 të Gjykatës Komunale e kishte lënë në fuqi. Ndër të tjera Gjykata Supreme kishte theksuar:

"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, ngase vendimi i Këshillit të punëtorëve të OBPB "Televizioni i Prishtinës" i miratuar më datë 2. 10. 1973, mbi bazën e së cilës i padituri ka lidhur kontratën për shfrytëzimin e saj me BVI-në përkatëse, asnjëherë nuk është anuluar me asnjë akt eventual apo procedure eventuale, prandaj si i tillë mbetet me efekt të plotë juridik. Edhe HABITAT-i i ka pranuar të drejtën e shfrytëzimit të paditurit në banesën lëndore sipas kërkesës së tij nr.DS 008127 me vendimin e Komisionit për çështje pronësore – banesore nr.HPCC/D/181/2005/A."

Duke theksuar më tej se:

"Me nenin 37 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore, është parashikuar që pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provojë se mbi

sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të paditësit. Në rastin konkret paditësi nuk ka provuar me prova të drejtën e pronësisë së patundshmërisë, dorëzimin e së cilës e kërkon, andaj aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është ndryshuar, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu që ka mbetur në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë e cila në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesa e paditësit është e pabazuar.”

27. Më 13 shtator 2011, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën KI121/11 në Gjykatë duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 134/2010, të 17 majit 2011.
28. Më 18 tetor 2012, Gjykata nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin KI121/11, me të cilin kërkesën e parashtrueses së kërkesës e shpalli të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e tanishme KI131/20

29. XH.J në pamundësi të shfrytëzimit të banesës, ku e drejta e banesës i ishte njohur përmes vendimit të DÇB-së [HPCC/D/181/2005/A&C] të 30 prillit 2005, dhe në bazë të këtij vendimi paditësi XH.J. kishte lidhur edhe kontratë për blerjen e banesës lëndore me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ai parashtroi padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër parashtrueses së kërkesës (e veja e personit F.S.) me kërkesën që: (i) paditësit t’ia dorëzojnë dhe lirojnë nga njerëzit dhe sendet paluajtshmërinë – banesën në Prishtinë, lagjja Ulpiana; (ii) të detyrohet parashtruesja e kërkesës që t’ia shpërblejë dëmin material nga pamundësia e shfrytëzimit të banesës; (iii) që kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë-banesës e lidhur në mes të N.V. si shitëse dhe F.S. si blerës, të shpallet nule dhe në të ardhmen të mos prodhojë efekt juridik.
30. Parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar kundër- kërkesëpadi pranë Gjykatës Themelore, kundër personit XH.J. dhe kishte kërkuar të vërtetohet se është pronare e banesës në fjalë.
31. Më 11 korrik 2014, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.2136/11]: (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit XH.J. si vijon: (ii) detyroi parashtruesen e kërkesës dhe NTP “Ledri Collection” në Prishtinë, që paditësit t’ia dorëzojë dhe lirojë nga njerëzit dhe sendet paluajtshmërinë në Prishtinë, lagjja Ulpiana, C-2, hyrja 1 banesën nr.17-podrum; (iii) u detyrua parashtruesja e kërkesës që paditësit XH.J. t’ia shpërblejë dëmin material nga pamundësia e shfrytëzimit të banesës për periudhën prej 24.09.2008 deri më 31.07.2014 në shumën 49.215.04 euro, ndërsa në të ardhmen nga data 01.08.2014, e tutje deri në dorëzimin e banesës, për çdo muaj të paguajë nga 650 (gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, kamatën nga dita e marrjes së aktgjykimit, sipas mjeteve të deponuara në banka mbi një vit, si dhe të dy të paditurit të paguajnë shpenzimet e procedurës; (iv) refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë të paditësit XH.J., me të cilën kishte kërkuar të vërtetohet se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë- për blerjen e banesës e lidhur në mes të N.V. si shitëse dhe F.S. si blerës e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me

Vr.4424/2005, dt.22.06.2005 me certifikata e pronës e njësisë 0-71714059-07435-1-Bl=0, ZK Prishtinë, zyra kadastrale në Prishtinë me të gjitha efektet që kanë prodhuar deri tani janë nule dhe të njëjtat si të tilla në të ardhmen nuk prodhojnë efekt juridik; (v) refuzoi si të pabazuar kundër-kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës e cila kishte kërkekuar të vërtetohet se është pronare e banesës në fjalë.

32. Kundër Aktgjykimit [C.nr.2136/11] të 11 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore, ankesë kishin parashtruar: (i) parashtruesja e kërkesës për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe propozoi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën aprovuese dhe detyruese si nën I,II dhe IV të dispozitivit të ndryshohet, dhe kërkesëpadia e saj të aprovohet dhe çështja të kthehet në rigjykim; (ii) paditësi XH.J. i cili kishte goditur aktgjykimin nën pikën III të dispozitivit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i goditur të ndryshohet.
33. Më 22 korrik 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.4715/2014] :(i) pranoi ankesën e paditësit XH.J., dhe prishi pjesën III të Aktgjykimit C.nr.2136/2011 të 11 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore, që ka të bëjë me refuzimin si të pabazuar të pjesës tjetër të kërkesëpadisë së paditësit me të cilën kishte kërkuar të vërtetohet se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë- për blerjen e banesës e lidhur në mes të N.V. si shitëse dhe F.S. si blerës e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me Vr.4424/2005, dt.22.06.2005 me certifikata e pronës e njësisë 0-71714059-07435-1-Bl=0, ZK Prishtinë, zyra kadastrale në Prishtinë me të gjitha efektet që kanë prodhuar deri tani janë nule dhe të njëjtat si të tilla në të ardhmen nuk prodhojnë efekt juridik, dhe në këtë pjesë lënda i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë; dhe (ii) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe NTP "Ledri Collection" XH.S.
34. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesja e kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
35. Më 25 qershor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.351/2019] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses së kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.4715/2014 të 22 korrikut 2019.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

36. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev.351/2019] të 25 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

37. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta duke mos e miratuar kundër- kërkesëpadinë e saj kanë bërë shkelje të barazisë para ligjit të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se në arsyetimin e aktgjytimeve të gjykatave të rregullta nuk paraqiten arsye të kuptueshme, dhe se arsyet e paraqitura janë kundërthënëse, si dhe sipas saj gjykatat kanë gjykuar një çështje të gjykuar.
38. Tutje, parashtruesja e kërkesës thekson se Gjykata Supreme duke mos e shqyrtuar revizionin e saj drejtë ka bërë shkelje të dispozitave të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Parashtruesja më tej thekson se *“kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë mbi bazën e të cilës bashkëshorti i ndjerë F.S si pronarë ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të kësaj paluajtshmërie mbi bazën e kontratës së shitblerjes e cila ende nuk është anuluar si e pavlefshme, andaj për deri sa kjo kontratë nuk anulohet me aktgjykim të formës së prerë në pajtim me dispozitat e nenit 20 al.1 lidhur me nenin 3 al.1 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësoreshme Juridike Bazë, i cili ka qenë ligj i zbatueshëm në Kosovë në kohën e lidhjes së kontratës, kjo kontratë është e vlefshme juridikisht dhe krijon efekte juridike ndërmjet palëve kontraktuese”*.
39. Parashtruesja e kërkesës thekson se në pajtim me praktiken e GJEDNJ-së, gjatë shqyrtimit të një çështje kontestuese vendimi gjyqësor duhet të ketë arsyetim të kuptueshëm në pajtim me standardet e së drejtës për gjykim të drejtë. Ajo tutje thekson se *“arsyetimi i vendimit gjyqësor është i kuptueshëm vetëm atëherë kur faktet me rëndësi vendimtare për gjykim të drejtë dhe ligjorë si dhe rrethanat e rastit konkret janë të arsyetuara, dhe arsytet e paraqitura për secilin fakt kontestues duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me përmbajtjen e vërtetë të provave të shqyrtuara, pa dispozitivi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore duhet të jenë të kuptueshëm, me arsyetim të plotë dhe të përshtatshëm për zbatim-përmbarim, pra si të tilla nuk duhet të jenë të pa qartë dhe të papërshtatshme për përmbarim”*. Lidhur me këtë parashtruesja e kërkesës thekson se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk e ka të kuptueshëm dispozitivin për arsye se nuk dihet se në cilën pjesë të dispozitivit është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore. Parashtruesja e kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së *Van De Hurk kundër Holandes*.
40. Në fund, parashtruesja e kërkesës nga Gjykata kërkon që: (i) kërkesa e saj të pranohet si e bazuar; (ii) të konstatohet se ekzistojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (iii) të anulohen aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe të shpallën të pavlefshëm.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
42. Gjykata rikujton se parashtruesja, për të njëjtën çështje ka parashtruar dy kërkesa në Gjykatë. Kërkesa e parë KI121/11 ishte deklaruar si e papranueshme përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI121/11.

43. Sa i përket kërkesës së tanishme KI131/20, ku parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev.351/2019] e 25 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme, Gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e vendimeve të gjykatave të rregullta që ndërlidhen me kërkesën KI131/20.
44. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet neneve 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

45. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

46. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.351/2019] e 25 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme; i ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë

shkelur; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

47. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtguesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

48. Gjykata vëren se, në thelb, të gjitha pretendimet e parashtgueses së kërkesës kanë të bëjnë kryesisht me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Lidhur me këtë, parashtguesja e kërkesës ankohet se në rastin e saj gjykatat kanë bërë vërtetim të gabuar të fakteve si dhe nuk i kanë arsyetuar vendimet e tyre mjaftueshëm.
49. Lidhur me këto pretendime, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për vërtetim të gabuar të fakteve, interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastin e Gjykatës nr. KIO6/17, parashtues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; rastin KI122/16, parashtues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe KI49/19 parashtues *Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 tetorit 2019, paragrafi 47).
50. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 37; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48).
51. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e

Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 49).

52. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
53. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur argumentohet se një gjykatë ka *“aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar”* në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës (përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KIO5/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shogëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
54. Në këtë kontest, Gjykata vëren që në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlidhet me pretendimin e parashtrueses së kërkesës lidhur me banesën të cilën pretendon se i takon asaj, në bazë të kontratës së shitblerjes që bashkëshorti i saj i ndjerë F.S. si blerës e ka lidhur me N.V. si shitëse. Banesa në fjalë ishte në kontest pronësor ndërmjet N.V. dhe Xh.J., ku pronësinë mbi banesën në fjalë e ka fituar personi Xh.J. në bazë të vendimit të DÇB-së [HPCC/D/181/2005/A&C] të 30 prillit 2005, dhe me këtë vendim ishin njoftuar palët, ashtu që e drejta e banesës i është njohur paditësit XH.J., ndërsa në bazë të këtij vendimi është lidhur edhe kontrata për blerjen e banesës lëndore ku si shitëse është Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe si blerës është XH.J., më 14 maj 2014, vërtetohet se paditësit XH.J. pasi i ishte njohur e drejta e banesës, të njëjtit i ishte mundësuar edhe blerja e banesës dhe me këtë ishte bërë pronar i banesës lëndore. Gjykatat e rregullta kanë vendosur që banesa i takon personit Xh.J. duku u bazuar në vendimin e DÇB-së i cili vendim është i formës së prerë dhe se vendimet e HPCC-së nuk i nënshtrohen vlerësimit të asnjë gjykate.
55. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës, dhe ishin arsyetuar vendimet e tyre duke u bazuar në faktet dhe provat relevante për rastin.
56. Për sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj [C.nr.2136/11] të 11 korrikut 2014, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Gjykata, pas vërtetimit të kësaj gjendje faktike, vlerëson se vendimi i HPCC (Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore) REC 76/2006, i datës 16 tetor 2006, me të cilin kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga z.Syla, refuzohet dhe me mbetjen në fuqi të vendimit të shkallës së parë HPCC/D,

181/2005, A&C dt.30 prill 2005 dhe me këtë vendim janë njoftuar palët, ashtu që e drejta e banesës ju është njohur paditësit XH.J, ndërsa në bazë të këtij vendimi është lidhur edhe kontrata për blerjen e banesës lëndore ku si shitës është Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe si blerës është XH.J, më dt.14.05.2014, vërtetohet se paditësi pasi ju është njohur e drejta e banesës, të njëjtit ju është mundësuar edhe blerja e banesës, kështu që sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë edhe është bërë pronar i banesës lëndore. Gjykata vlerëson se vendimi i dt. 30 prill 2005, i HPCC-së, është akt formal juridik sepse është i formës së prerë, nga momenti kur është lënë në fuqi, me vendimin e dt. 16 tetor 2006, dhe është akt material juridik sepse paditësit ju është njohur e drejta e banesës, kështu që vendimet e HPCC janë vendime që nuk i nënshtrohen vlerësimit të kësaj gjykate dhe e obligojnë këtë gjykatë.

Gjykata vlerëson se HPCC me rastin e marrjes së vendimit të saj, dt.30 prill 2005, të drejtën e banesës ja ka njohur paditësit, kurse për këtë rrethanë është njoftuar shitësja, sikundër edhe blerësi F.S tani i ndjerë, këta me lidhjen e kontratës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me Vr.4424/2005, dt.22.06.2005, gati dy muaj pas marrjes së vendimit të HPCC, kanë rrezikuar vetë dhe të dy palët kontraktuese janë palë me keqbesim. Kjo gjykatë nuk ka autorizim ligjor të vlerësoi ligjshmërinë e vendimit dt.30 prill 2005, por në rastin konkret sipas vlerësimit të kësaj gjykate, vendimi në fjalë është i formës së prerë dhe detyrues për palët që kanë pasur kërkesë dhe për palët që kanë lidhur kontratë pas kësaj date. Kështu që gjykata vlerëson se vendimi i HPCC është obligativ edhe për këtë gjykatë, dhe ky vendim është akt juridiko material sepse paditësit XH.J ja njeh të drejtën e posedimit, dhe në bazë të këtij akti paditësi e ka blerë banesën nga AKP-ja, kështu që për shkak të këtyre rrethanave, kjo gjykatë vlerëson se nuk ka bazë juridike pretendimi i kundër paditëses sa i përket fitimit të pronësisë sipas bazës më të fortë juridike, në kuptim të nenit 41 të LTHMPJ, dhe për këtë arsye u refuzua kundër kërkesëpadia e paditëses A.S.”

57. Duke adresuar pretendimet e njëjta, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të saj [Ac.nr.4715/2014] të 22 korrikut 2019, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Me vlerësim të drejtë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë në mënyrë bindëse dhe në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike relevante për marrjen e vendimit në këtë kontest, duke vërtetuar drejtë se paditësi është pronar i paluajtshmërisë kontestuese dhe pasi që është pronar, atëherë me të drejtë ka vërtetuar se qëndron detyrimi i të paditurve që paditësit t’ia dorëzojnë dhe lirojnë nga njerëzit dhe sendet paluajtshmërinë kontestuese si dhe drejtë ka detyruar të paditurën e parë A.S që paditësit t’ia shpërblejë dëmin material nga pamundësia e shfrytëzimit të banesës për periudhën prej datës 24.09.2008 e deri me datë 31.07.2014, në shumë prej 49.215,04 euro, ndërsa në të ardhmen nga data 01.08.2014 e tutje deri në dorëzimin e banesës, për çdo muaj të paguaj nga 650 euro, kamatën dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.664 euro. Njëherit kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë me vlerësim të drejtë të provave të administruara ka vërtetuar drejtë edhe gjendjen faktike lidhur me kërkesëpadinë e kundër paditëses A.S dhe me zbatim të drejtë të

së drejtës materiale drejtë ka refuzuar kundër padinë që të vërtetohet se është pronare e paluajtshmërisë kontestuese sipas bazës më të fortë juridike dhe në këtë drejtim ka dhënë arsye të mjaftuara, e të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.”

58. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.351/2019] kishte refuzuar revizionin e parashtrueses së kërkesës, ku ndër të tjera theksoi:

“Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e revizionit se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 (n) të LPK, ngase siç theksohet dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna në të dhe se arsyetimi nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi goditur nuk është përfshirë me shkelje të tilla në procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit përmban sendin individualisht të caktuar, dorëzimi i të cilit kërkohet dhe atë me të gjitha shënimet për banesën kontestuese, prandaj nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se nuk ka shënime për banesën kontestuese.

Thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë e refuzon kërkesën nga kundërpadia e të paditurve, vetëm për faktin se nuk janë dorëzuar origjinalet e provave lidhur me dhënien e banesës, janë të pabazuara nga arsyet se vendimi i HPCC Rec.nr.76/2006 i datës 16 tetor 2006, me të cilin kërkesa e parashtruar nga F.S refuzohet si e pathemeltë dhe lihet në fuqi vendimi i shkallës së parë HPCC D181/2005 të datës 30 prill 2005, me të cilin i është njohur e drejta e banimit paditësit, ashtu që vendimet HPCC janë vendime që nuk i nënshtrohen vlerësimit të gjykatës dhe obligojnë gjykatën në bazë të nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23. Në bazë të nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 është e përcaktuar se: “Çdo person i cili ka humbur të drejtën e pronësisë në periudhën ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe 24 mars 1999, si pasojë e diskriminimit, ka të drejtë për rikthimin e saj në pajtim me këtë rregullore, rikthimi mund të jetë në formë të rivendosjes të drejtës mbi pronën ose kompensimin”. Paditësi i cili ka humbur të drejtën e shfrytëzimit në banesë si pasojë e diskriminimit, i njëjti ka fituar të drejtën e rikthimit me vendimin e HPCC të datës 30.04.2005 dhe në bazë të këtij vendimi ka fituar të drejtën e blerjes së banesës në bazë të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (04/L-061), dhe çdo kontratë e shitjes, pas vendimit të HPCC në bazë të nenit 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 është e pavlefshme dhe nuk ka forcë ligjore. Prandaj, edhe pretendimet e të paditurit se paditësi nuk ka mundur të lidh kontratë të shitblerjes me AKP-në janë të pabazuara pasi që banesa ka qenë e regjistruar në emër të paditësit.”

59. Rrjedhimisht, dhe siç është elaboruar më lart, Gjykata vëren që të gjitha gjykatat e rregullta kishin konstatuar se vendimet e HPCC-së janë vendime të formës së prerë dhe se nuk mund të shqyrtohen nga asnjë instancë tjetër administrative dhe gjyqësore. Lidhur me çështje të njëjta Gjykata ka vendosur edhe në raste të tjera, ku ka konstatuar se vendimet e HPCC-së janë vendime të formës së prerë – *res judicata* (shih rastet e Gjykatës: KI104/10, parashtrues Draža Arsić, Aktgjykim i 23 prillit 2012; KI44/20, KI83/20 dhe KI102/20, parashtrues

Besnik Kavaja, Aktvendim për papranueshmëri i 22 shkurtit 2021, paragrafi 83).

60. Pra, Gjykata thekson se një nga parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike është parimi i sigurisë ligjore. Kjo vlen sidomos për sa i takon vendimeve gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë, qoftë person fizik apo person juridik, nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin, revokimin, rikonsiderimin apo shfuqizimin e një vendimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm, thjesht për qëllim të fitimit të një rishikimi dhe rishqyrtimi të freskët të rastit (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, nr. 48553/99, § 72, GJEDNJ 2002-VII, si dhe *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ 2003-IX).
61. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se rishikimi, revokimi, rishqyrtimi ose shfuqizimi i një vendimi përfundimtar dhe detyrues do të çonte në një pasiguri të përgjithshme juridike, që do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të sundimit të ligjit. Me fjalë të tjera, kthimi i vendimeve të formës së prerë do të rezultonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë ligjore e cila do ta bënte rendin juridik krejtësisht joefektiv. Si pasojë, besimi i publikut në sistemin gjyqësor dhe në vetë sundimin e ligjit do të zvogëlohej dukshëm.
62. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kishin trajtuar dhe arsyetuar në tërësinë e tyre pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe se procedurat para gjykatave në rrethanat e rastit konkret, në asnjë mënyrë nuk rezultojnë të kenë qenë të padrejta apo arbitrare.
63. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se "*drejtësia*" që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës nr. KI42/16 parashtrues *Valdet SUTAJ*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
64. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih rastet e Gjykatës: KI118/17 parashtrues *Šani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
65. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimin e ngritur nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesja e kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet

mjaftueshëm pretendimin e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

66. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht me vendimet e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit, dhe atë të Gjykatës Themelore, apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21.; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
67. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
68. Si përfundim, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullat 39 (2), dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 5 maj 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi